

Kanadezit i duhet një fjalor gegnisht

Intervistë retrospektive: Robert Elsie

“Shqiptarët ndryshojnë më shpejt se popujt e tjerë, e kam përshtypjen. Natyrisht kanë shumë rrugë për të ecur, janë prapa gjithë të tjerëve, por ecin shpejt,” thotë Elsie.

Robert Elsie (1950) mund të quhet albanologu më i njohur i huaj, i gjallë. Tani që është në moshën 60-vjeçare, ai ka harxhuar gjysmën e jetës së tij duke i ndjekur për së afërmi shqiptarët, duke i përkthyer ata, duke udhëtuar e gjurmuar nga bibliotekat e Turqisë në ato të priftërinjve në Paris, shkurt, rreth gjithçka çka ka të bëjë me shqiptarët. Po ashtu është kursyer dhe nga disa pyetje të shtjerra si ajo se çfarë mendon për ‘Historinë e Letërsisë Shqipe’ të botuar në vitin 1983. Po, ka thënë disa herë nëpër intervista se “është një mashtrim dhe një krim kundër kulturës shqiptare”. Ose, ç’mendon për përkthimin e letërsisë shqipe në botë. Është përgjigjur për këtë. Madje shumë herë.

Biseda me të në Institutin Albanologjik ishte rreth shqiptarëve dhe ndryshimeve 30 vjet nga koha kur kishte ardhur për herë të parë në Shqipëri më 1978. Ai flet edhe për identitetin shqiptar, komenton debatin Kadare-Qosja, nacionalizmin shqiptar, letërsinë dhe tregon arsyen e mospjesëmarrjes këtë vit në seminarin e gjuhës. R. Elsie shprehet edhe rreth identitetit kosovar dhe fjalorin që e kishte kërkuar “kosovarçe-anglisht.”

[KB]: *Z. Elsie, ku janë shqiptarët sot, përfshirë aspektin politik dhe atë kulturor, krahasuar me fundvitet e shtatëdhjeta kur edhe keni nisur studimin mbi shqiptarët?*

[RE]: Për studimet erdha në tokën shqiptare në fund të viteve të shtatëdhjeta, në ’78-n në Shqipëri dhe në ’79-n në Kosovë. Dhe isha vazhdimisht këtu, më shumë në Kosovë, në vitet ’80, pastaj në Shqipëri edhe kur u hap në vitet ’90. Shoqëria shqiptare është shumë interesante në një mënyrë. Zhvillohet shumë shpejt, ndryshohet shumë shpejt. Çdo vit Kosova është ndryshe, çdo vit Shqipëria është ndryshe. Shqiptarët ndryshojnë më shpejt se popujt e tjerë, kam përshtypjen. Natyrisht kanë shumë rrugë për të ecur, janë prapa gjithë të tjerëve, por ecin shpejt.

[KB]: *Sa janë prapa të tjerëve krahasuar me shtetet fqinjë?*

[RE]: Po, them se janë, Mirë, krahasuar me vendet e Ballkanit nuk jam i sigurt që janë prapa të gjithëve, por janë prapa Evropës sigurisht, për shkak të historisë së Shqipërisë, historisë së Kosovës është e qartë, varfërisë, prapambetjes, në çdo drejtim ka prapambetje, apo jo?!

[KB]: *Në kohën kur keni ardhur ju, Shqipëria ka qenë nën komunizëm, ndërsa Kosova ka qenë e okupuar nga Serbia. Dhe sigurisht, realiteti i atëhershëm dhe realiteti i sotëm ka një dallim. Sa kanë ndryshuar shqiptarët, sa kanë përparuar dhe çfarë duhet të bëjnë ata?*

[RE]: Kanë përparuar shumë, them unë. Një shqiptar i Shqipërisë me tha njëherë – është më shumë barceletë – por tha se, ne zhvillohemi më shpejt se bullgarët. Në kohën kur bullgari ndërton shtetin e vet, ne e kemi ndërtuar 5 herë Shqipërinë, dhe e kemi rrafshuar 5 herë atë. Kjo është Shqipëria, një kulturë e cila zhvillohet shpejt, me shumë gabime, por ecën përpara, them unë.

[KB]: *Ju jeni marrë me mitologjinë, historinë, me religjionin, me folklorin shqiptarë. Rreth çështjes së identitetit shqiptar ka pasur një debat të ashpër ndërmjet dy personaliteteve të shquara të kulturës shqiptare, ndërmjet Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qoses, për të cilin Qosja kishte shkruar tre libra, ndërsa Kadareja ishte mjaftuar me një dhe disa intervista. Nëse e keni përcjell këtë debat, çfarë është komenti juaj?*

[RE]: E kam përcjell. Të paktën pjesërisht. Nuk e di në çfarë masë e kam përcjell këtë debat në tërësi, por e mbaj mend para disa vjetëve ishte një debat i ashpër. Tejkaloj kufijtë e shkencës sipas meje. Të dy mendimet janë me vlerë. Unë do të thosha megjithatë se nuk mund të mohosh pjesën orientale, pjesën islame të kulturës shqiptare. Është një pjesë përbërëse e popullit shqiptar. Dhe nuk ka arsye pse të mohohet kjo. Pse të thuhet shqiptarët janë të krishterë, gjithmonë kanë qenë të krishterë? Nuk është e vërtetë. Kanë 500 vjet që janë në botën islame dhe kjo ka pasur një ndikim të thellë në mentalitetin shqiptar edhe sot e kësaj dite vazhdon ky mentalitet. Nuk është një gjë që duhet vlerësuar detyrimisht keq. Ka edhe elemente të prapambetjes që lidhen sigurisht me botën orientale, me Turqinë e vjetër, mbase me islamin, nuk e di. Por ka dhe anën e mirë, për mua, ka dhe anën interesante.

[KB]: *Perandoria Osmane është shtrirë, ose të themi kultura orientale është shtrirë edhe në vende të tjera të Evropës, për shembull edhe në Spanjë dhe disa vende të tjera, pastaj edhe në Bosnje. Islamizimi i shqiptarëve, a është pengesë për hyrje në Evropë?*

[RE]: Jo, nuk besoj, nuk besoj. Ka gjithmonë thashetheme për këtë, por nuk besoj fare. Edhe ana islame e shqiptarëve nuk është kaq e thellë si për shembull ajo në botën arabe. Është një islam krejt tjetër, është një islam liberal që nuk shkakton asnjë dëm. Edhe në fund të fundit, sa milion myslimanë ka në Bashkimin Evropian tani? Ka sigurisht 5 ose 10 milion myslimanë në Evropë. Në Gjermani, në Francë dhe në vende të ndryshme. Dhe janë pjesë përbërëse e shoqërisë evropiane.

[KB]: *Ju e konsideron të frytshëm debatin Kadare-Qosja?*

[RE]: Unë e konsiderova të frytshëm në fillim. Por pastaj kur tejkaloj “zullumin”, siç thoni ju, më dukej se nuk sollli asgjë. Ishin inatet e dy palëve. Unë i kuptoj të dy palët, kanë mendimet e tyre, por prapë nuk ka nevojë për një inat kaq të thellë në një debat mendimesh.

[KB]: *Pasi që jemi tek Ismail Kadare dhe Rexhep Qosja, që të dy kanë botuar se fundmi libra letrare. Kadare ka botuar ‘Aksidentin’ në shqip, ndërsa Qosja ‘Bijtë e askujt’. Ky i fundit lidhet shumë me këtë temë, pra me debatin me Kadarenë. I keni lexuar? Çfarë është komenti juaj?*

[RE]: ‘Aksidentin’ e kam lexuar, por librin e Qoses nuk e kam lexuar, nuk mund t’ju them gjë.

[KB]: *Që nga intervista e para, për shembull, dhënë Rilindjes në vitin 1987 deri tek intervista e fundit e një viti më parë, vazhdoni të thoni se “letërsia shqipe është fare pak e njohur në botë”, përkundër disa shkrimtarëve – si për shembull Ismail Kadare, të cilët thonë se letërsia shqipe megjithatë është e njohur në botë.*

[RE]: Çfarë të them unë (qesh). Besoj se në vija të përgjithshme nuk është e njohur letërsia shqiptare. Është një letërsi e vogël. Por prapë ka botime, nuk them që nuk ka asnjë botim. Veprat e Kadaresë njihen në botë, kurse autorët e tjerë... Mirë, ka botime, por janë kryesisht tirazhe të pakta, shtëpi botuese të vogla, ku librat nuk shpërndahen shumë. Rasti i Qoses, për shembull. Libri ‘Vdekja më vjen prej syve të tillë’ u botua gjermanisht, madje dhe holandisht. Por nuk them që ka qarkulluar shumë, edhe shumë libra të tjerë shqiptarë botohen, por nuk kanë qarkullim. Nuk kanë shumë ndikim në mendimin publik ndërkombëtar. I vetmi autor që ka çarë bllokadën, si të themi, është Kadareja, kuptohet.

[KB]: *Sipas jush, a është liruar letërsia shqipe sot nga kodi nacional ose dhe nga ideologjitë e kaluara?*

[RE]: Letërsia, apo në përgjithësi shkrimet në shqip, përfshirë shkencën shqiptare, sigurisht nuk është liruar nga nacionalizmi shqiptar. Është një ideologji shumë e dëmshme për mua. Unë kam thënë kohët e fundit në një botim, se historia e letërsisë është e ndikuar keq nga dy ideologji. Nga ideologji komuniste që ka kaluar tani, dhe nga ideologjia nacionaliste shqiptare. Kjo frymë nacionaliste mbetet në shumë libra shqiptarë, jo aq shumë në letërsinë artistike - mbase letërsia artistike nuk do të dëmtohej - por në shkencë është e dëmshme.

[KB]: *Të bisedojmë pak rreth Seminarit të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare, i cili përfundoi para pak ditësh. Meqë ishit pjesëmarrës për shumë vite në këtë seminar, përse munguat këtë vit?*

[RE]: Sepse nuk kisha kohë.

[KB]: *Keni shkruar për eposin e kreshnikëve. Ndërsa jeni në Kosovë në konferencën dyditore që po mbahet këto ditë për këtë vlerë trashëgimore. Na flisni diçka rreth këtij organizimi?*

[RE]: Konferenca për mua është shumë e rëndësishme, sepse këngët e kreshnikëve janë një element thelbësor i kulturës shqiptare që duhet të njihet në botë. Ka një lëvizje tani, që këngët e kreshnikëve të pranohen si vlerë humanitare, vlerë e UNESCO-se, që më duket një gjë shumë e mirë. Polifonia shqiptare në jug është pranuar nga UNESCO-ja, apo është zyrtarizuar. Dhe do të ishte mirë gjithashtu që edhe këngët e veriut të njihen. Natyrisht nuk i shpëton ato. Këngët e kreshnikëve po vdesin nga tradita e gjallë. Jemi në

brezin e fundit të lahutarëve tani, nuk ka më. Dhe pas disa vjetëve shuhet. Kështu që është me rëndësi të mblidhemi këtu, të takohemi, të shkëmbejmë mendimet, të shohim çfarë mund të bëjmë për të regjistruar atë pjesë të fundit të kësaj tradite. Të ruajmë në incizime, në libra, aq sa mundemi, përpara se të vdesë kjo dukuri.

[KB]: *Çfarë është duke punuar tani Robert Elsie?*

[RE]: Jam në përfundim të një libri tani me mjaft interes për Kosovën, besoj. Është një leksikon, apo një doracak për Kosovën që do të botohet në anglisht. Do të ketë afërsisht 500 faqe, 350 deri në 400 zëra për Kosovën, pra, është një biografi historike e personaliteteve të njohura të Kosovës. Është edhe për Kosovën si shtet në përgjithësi, për ekonominë, historinë, hekurudhën, politikën, zhvillimet e fundit, zhvillimin historik të Kosovës, si një lloj leksikoni. Ky libër do të dalë në Shtetet e Bashkuara në dhjetor 2010 besoj, në anglisht, dhe po përkthehet në shqip. Pra, mbase do të dalë edhe në gjuhën shqipe. Për mua është një libër i madh, sepse është prezantimi i parë gjithëpërfshirës i Kosovës si shtet, si të gjithë shtetet e tjera.

[KB]: *Është dhe një çështje e fundit që do të kisha dashur të bisedonim. Në vitin 2000 në një intervistë dhënë Kohës Ditore rreth veprës 'Një fund dhe një fillim', keni përmendur dy realitete shqiptare. Keni thënë tekstualisht se "është e qartë për çdo njeri se ka një realitet kosovar, një kulturë kosovare, një jetë kosovare dhe, në anë tjetër, një realitet në Shqipëri," dhe keni thënë se lypset shumë kohë që të bashkohen realitetet. Keni thënë gjithashtu se, megjithatë, nuk kërkoni detyrimisht ribashkim vlerash, duke i quajtur dallimet si pasuri e kulturës shqiptare. Z. Elsie, disa vjet me pas, ka nisur një debat i nxehtë që ende nuk është shuar tërësisht nëpër medime rreth identitetit kosovar. Si e keni parë ju si një i huaj ketë debat dhe a mund të konsiderohet i dëmshëm dhe përçarës për kombin shqiptar?*

[RE]: Fjalët që i kam shkruar para shumë vjetëve sipas meje qëndrojnë edhe sot. Nuk shoh asnjë ndryshim të madh. Unë besoj që ka, qartë, një identitet kosovar. Dhe identiteti kosovar nuk është në kundërshtim me identitetin shqiptar. Është pjesë e identitetit shqiptar. Nuk besoj se kombi shqiptar rrezikohet që të ketë disa identitete, dhe ka në fakt identitete të shumta. Nuk ka NJË identitet shqiptar. Nuk ka pasur kurrë NJË identitet shqiptar. Çdo shqiptar ka një identitet lokal (qyteti i tij), ka një identitet profesional, ka një identitet fetar, ka një identitet kombëtar, por e koncepton ndryshe. Nuk ka NJË identitet kosovar dhe kurrë nuk ka pasur. Por, në fund të fundit, është puna e kosovarëve të vendosin vetë se si është identiteti i tyre. Nuk ju them unë se çfarë është identiteti juaj. Ju do të më thoni mua si e konceptoni veten, apo jo? Se si është identiteti kosovar, më thoni ju mua.

[KB]: *Ju keni kërkuar një fjalor kosovarçe-anglisht në Londër, në konferencën e dytë të studimeve mbi kulturën gege ose atë të veriut, që nuk u prit mirë nga intelektualët në Tiranë. Si e komentoni këtë?*

[RE]: Unë pata kërkuar një fjalor gegnisht-anglisht. Ka një fjalor shqip (në gjuhën letrare)-anglisht, por duhet edhe në fjalor gegnisht. Unë nuk e dija atë kohë se sa

kontroverse ishte ky mendim. Sot dëgjova me kënaqësi nga një shkencëtar këtu në Kosovë që ka përgatitur një fjalor gegnisht-gegnisht, apo gegnisht-shqipe letrare. Ka shumë nevojë për një fjalor të tillë. Nevojat janë praktike, për shembull, kosovarët që jetojnë jashtë në Angli, në Londër, dhe nuk dinë anglisht. Futen në spital, flasin, komunikojnë vetëm në gjuhën e tyre, komunikojnë gegnisht. Anglezët, si të gjejnë këto fjalë në fjalorin e gjuhës letrare? Nuk i gjejnë dot. Domethënë, ka një nevojë shumë praktike. Nuk është çështje ideologjike, është vetëm një fjalor. Unë nuk e konceptoj dot pse një fjalor duhet të jetë çështje ideologjike. Megjithëse e kam parë se në Ballkan konceptohet kështu. Një miku im, Viktor Friedman nga Çikago, ishte para një viti në Athinë për të paraqitur një fjalor maqedonisht-greqisht. Dhe mbledhja është ndërprerë nga ekstremistët grekë, të cilët u futën në sallë dhe ishin shumë të mërzitur pse ky fjalor po paraqitej. Ishte vetëm një fjalor, pra me fjalë... Dhe shkaktoi një reagim të tmerrshëm nga disa njerëz në Greqi. Mund të jetë kështu dhe në Kosovë, nuk e di. Nuk besoj që shkon aq larg si në Greqi. Por shoh që ka një anë emocionale për fjalorët.

Intervistoi: Kreshnik Berisha

[Published in / botuar në: *Koha ditore*, Prishtina, 4 September/shator 2010, p. 28.]